



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3535 Prot.

Tiranë, më 30.6.2020

U R D H Ë R

Nr. 175, datë 30.6.2020

PËR

**ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR AUTORITETET DHE
ORGANET DREJTUESE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 7 dhe 131 të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U R D H Ë R O J:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në datën 30.6.2020.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, të jetë data 30.7.2020.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë, në vijim të procesit të ndjekur deri më tani në zbatim të urdhrave të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.8, datë 14.01.2020, "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar dhe nr.108 datë 08.05.2020 "Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19", të marrin masa për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

